

VENDIM
Nr. 790, datë 14.11.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN N. 578, DATË 29.8.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË KALIMIT NË PRONËSI TË OBORREVE NË
PËRDORIM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “b” e pikës 9 të vendimit nr. 578, datë 29.8.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Verifikimi i kushteve të parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga punonjësit e AKKP-së.

Nëse gjatë inspektimit në terren rezulton se brenda apo në lidhje funksionale me sipërfaqen e oborrit në përdorim, gjenden vetëm ndërtime informale, AKKP-ja procedon menjëherë me mospranimin e kërkesës për tjetërsim, duke njoftuar kërkuuesin, me vendim të arsyetuar me shkrim, për mosplotësimin e kushtit të parashikuar në shkronjën “ç” të pikës 5 dhe në pikën 6 të këtij vendimi.”.

2. Kërkesat e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për të cilat ende nuk është dhënë vendim nga AKKP-ja, vazhdojnë të shqyrtohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha